



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 06.07.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 02.07.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "NNP WENDA" për aktivitetin: "Ndertimi i salles se edukates fizike ne shkollen e Busise" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-9179-521 nxjerr:

VENDIM

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "BRT" e datës 02.07.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i salles se edukates fizike ne shkollen e Busise" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-9179-521, kundër Njoftimit për Vendimin e AK-se te datës 02.03.2020, te publikuar ne web-faqe te KRPP-së.

1. Vërtetohet Njoftimi për Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës 01.07.2020;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "BRT" me datë 02.07.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i salles se edukates fizike ne shkollen e Busise" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-9179-521.

Autoriteti Kontraktues, me datë 06.07.2020 ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar dispozitat ligjore lidhur me cmimet jonormalisht te ulta jane te pa bazuara, pasi qe AK-ja ka kerkuar sqarimet ne harmoni me te njejtat;

-Pretendimet se nuk eshte respektuar Vendimi i OSHP-se poashtu jane te pa qendrueshme, pasi qe Vendimi im per refuzim te rekomandimit te komisionit ka qene i bazuar pikerisht ne te njejtin; dhe

Pretendimi vijues per cmim jonormalisht te ulet per pozicionet e betonit te tenderusit te rekomanduar per kontrate poashtu jane te pa qendrueshme,pasi qe ne te njejtat ju keni cmime me te ulta nga i njejt.

Bazuar ne sqarimet e dhena per pretendimet tuaja u vendos si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

